



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 40 regjistër (JR)
Datë 04.09.2019

Nr. 30 i vendimit
Datë 11.11.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 11.11.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 40/2019, datë 04.09.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 186, datë 23.07.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 e vijim; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, nenet 136, 136/1, 136/3, 139 e vijim; ligji ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016, nenet 136/113/5, 139, 139/2, 179/4, 179/b, 179/b/2, 179/b/5, neni G e vijim; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e vijim; ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 63, 4/6, 47, 3/16, 58/1, 66/1/c e vijim; ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, neni 46 e vijim; ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 1, 3, 5, 7, 11, 12, 22, 36, 61, 62, 64, 65 e vijim.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet përfaqësueses ligjore të saj, avokate E. Q., pasi vendosi me shumicë votash për mbylljen e shqyrtimit gjyqësor, dëgjoi avokaten e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e pjesës së vendimit të Komisionit, përkatësisht pikën 2 të këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 186, datë 23.07.2019, vendosi:
 1. *Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, është ndërprerë.*
 2. *Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
 3. *Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
 4. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

II. Shkaqet e ankimit

2. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) duke kërkuar prishjen pjesërisht të vendimit, për pikën 2 të tij, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, dhe pushimin e gjykimit të çështjes.
3. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

3.1 Lidhur me shkeljet procedurale, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, mbështetur në jurisprudencën e Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Kushtetuese; dhe se procedura e ndjekur nga Komisioni nuk është bazuar në parimet bazë të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin e Procedurave Administrative apo në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

3.2 Lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material për pikën 2 të dispozitivit të vendimit, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se pika 2 e dispozitivit të vendimit të Komisionit është konfuze dhe e paqartë, e marrë në bazë të provave dhe fakteve që nuk ekzistojnë, në mungesë të plotë të analizës logjike dhe juridike, si dhe në konkluzione tërësisht të pabazuara në ligj.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e anëtares së Gjykatës së Lartë e, për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
5. Shqyrtimi i çështjes në Kolegj, në rastet kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, përveç rasteve kur trupi gjykues çmon se jemi përpara kritereve të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 dhe vendos që çështja të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike në prani të palëve.
6. Nga subjekti i rivlerësimit, më datë 13.10.2020, përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, është dërguar pranë Kolegjit një kërkesë *Për pezullimin e procesit të gjykimit të ankimit të paraqitur nga ankuesja Arjana Fullani pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit deri në zgjidhjen e çështjes gjyqësore nr. 31155-01148-86-2020 pranë Gjykatës së Apelit Administrativ*, me palë ndërgjyqëse, paditëse Arjana Fullani, i paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor, me objekt padie *shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ nr. 67, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë Arjana Fullani, për shkak të mbarimit të mandatit*.
7. Trupi gjykues, në seancën gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 16.10.2020, paraprakisht u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e gjykimit të çështjes në Kolegj deri në zgjidhjen e çështjes gjyqësore të ngritur para Gjykatës së Apelit Administrativ, që lidhej me shfuqizimin pjesërisht të vendimit të KLGj-së nr. 67 datë 24.04.2019, duke kontestuar në kërkesëpadi vetëm shkakun e përdorur nga KLGj-ja si bazë për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit.
8. Pasi u analizua kjo kërkesë në dhomë këshillimi, në këndvështrim të parashikimit ligjor të nenit 297/1, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues me shumicë votash vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë për pezullimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegj dhe vijimin e shqyrtimit të saj në dhomë këshillimi, duke arsyetuar se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Administrativ sipas objektit dhe palëve ndërgjyqëse si më sipër nuk përbën pengesë për shqyrtimin e kësaj çështjeje në Kolegj, pasi bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, objekt i shqyrtimit në Kolegj është vendimi i Komisionit, vendimmarrje e cila ka disponuar për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit pas verifikimit të vullnetit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, për heqjen dorë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtares. Trupi gjykues vlerësoi se objekti i gjykimit si i tërë është ngritur brenda juridiksionit të posaçëm të Kolegjit në kuadër të procesit të rivlerësimit, i cili është parashikuar nga neni F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës si i vetmi organ gjyqësor në kuadër të këtij procesi, për pasojë ky juridiksion nuk mund t’u përkasë gjykatave të zakonshme.
Nga shqyrtimi i kërkimeve të subjektit në kërkesëpadinë e paraqitur për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, por edhe nga pretendimet e parashtruara në ankim, rezulton se subjekti nuk ka pretenduar dhe as pretendon në asnjë formë se statusi i magjistratit vazhdon të gëzohet prej saj për shkak të vendosjes së një shkakut të gabuar në vendimin e deklarimit të mbarimit të statusit. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë konsekuent në qëndrimin e tij se statusi i magjistrati nuk gëzohet më prej tij, dhe kjo rrethanë determinon për shkak të ligjit ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Nisur nga kjo predispozitë, Kolegji vlerëson se verifikimi dhe vlerësimi i rrethanave

që përcaktojnë aplikimin ose jo të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, e cila përbën edhe vetë kërkimin e subjektit në ankim, është një çështje krejtësisht e juridiksionit të rivlerësimit dhe rregullohet nga kuadri ligjor që normon këtë proces, për pasojë vendimmarrja e Kolegjit në këtë drejtim nuk mund të kondicionohet nga qëndrimet e një gjykate të zakonshme, siç është Gjykata e Apelit Administrativ.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i vetë shkaqeve të ankimit dhe shkaqeve të pasqyruara në kërkesëpadi, lexohet qartë se kërkimi që subjekti ka parashtruar në këto dy akte, që janë thelbësisht të njëjta, duke kundërshtuar në të dyja rastet shkakun e dorëheqjes si bazë për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, e parë kjo kërkesë lidhur ngushtë me pasojat që vijnë nga zbatimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, e cila në këtë rast përcakton edhe prevalimin e juridiksionit të posaçëm të Kolegjit në shqyrtimin e saj.

Të njëjtin qëndrim¹ si më lart mbajti edhe përfaqësuesja e subjektit në seancë gjyqësore publike, në të cilën parashtroi se: [...] *Unë e kuptoj që ju morët atë vendim për të mos pezulluar, por ju keni të gjithë tagrat që edhe pse keni marrë atë vendim për të mos e pezulluar gjykimin, ta shqyrtoni këtë çështje dhe të merrni në konsideratë faktin që ky shkak ligjor i gjetur nga KLGj-ja për përfundimin e statusit të magjistratit, është një shkak i paparashikuar në ligj, është një shkak i stisur, shkak i sajuar që nuk parashikohet në nenin 64/1 për përfundimin e statusit të magjistratit dhe për rrjedhim ka sjellë atë pasojë që thotë “që ju nuk aplikuat, të përfundon statusi i magjistratit.”. Pra, ju duke qenë se jeni gjykata më e lartë në nivelin e Gjykatës Kushtetuese dhe në nivelin e gjykatës rishikuese keni të drejtë të kontrolloni dhe këtë dhe jo vetëm këtë, keni të drejtën të kontrolloni dhe procedurën se si është zhvilluar marrja e këtij vendimi nga ana e KLGj-së, sepse KLGj-ja nuk mundet t’i dërgojë një letër ish-anëtarit të Gjykatës së Lartë, siç i dërgoi znj. Fullani [...].*

9. Trupi gjykues në vijim vendosi vazhdimin e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, duke analizuar shkaqet procedurale të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me procesin e rregullt ligjor.
10. Referuar vendimit të Komisionit nr. 186, datë 23.07.2019, çështja që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, është shqyrtuar në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në mungesë të seancës dëgjimore me subjektin e rivlerësimit dhe në përfundim krahas ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka vendosur të deklarojë dhe humbjen e së drejtës së saj për t’u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
11. Trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet procedurale të ankimit, konstatoi se vendimi i Komisionit është marrë mbi shkelje të rënda procedurale të kryera nga Komisioni përgjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, dhe në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për t’i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në mënyrë efektive.

¹ Nga transkriptimi i audios së seancës gjyqësore publike (ora 12:59:09).

12. Subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike ishte i pranishëm dhe dha parashtrimet e tij nëpërmjet përfaqësueses ligjore, lidhur me shkeljet procedurale të kryera nga Komisioni, si dhe me zbatimin e gabuar të ligjit material për pikën 2 të dispozitivit të vendimit.

III/1. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit për zbatimin të gabuar të ligjit material

13. Subjekti i rivlerësimit në ankim, si dhe në parashtrimet e dhëna në seancë gjyqësore publike, pretendon se pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 186, datë 23.07.2019, të Komisionit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe është tërësisht konfuze dhe e paqartë, marrë në bazë të provave dhe fakteve që nuk ekzistojnë, në mungesë të plotë të analizës logjike dhe juridike, konkluzioneve tërësisht të pabazuara në ligj. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e parashtroi duke u fokusuar në tri momente kryesore:

13.1 A mund të vazhdonte ushtrimin e detyrës në cilësinë e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë edhe pas përfundimit të mandatit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 76/2016?

13.2 Kur fillonte dhe kur mbaronte statusi i saj si magjistrate, në cilësinë e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë, dhe a përfundonte statusi i saj për efekt të ligjit me mbarimin e mandatit kushtetues 9-vjeçar?

13.3 A mund të penalizohet nga mosaplikimi i një të drejte të dhënë nga ligji dhe a është i zbatueshëm në rastin konkret dhe i parashikuar në ligj, sanksioni i dhënë nga Komisioni në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 186, datë 23.07.2019?

14. Trupi gjykues, pasi dëgjoji parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore publike, si dhe analizoi të gjitha aktet e administruara në dosjes gjyqësore, konstaton:

14.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, është emëruar në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë me vendimin² e Kuvendit nr. 206, datë 28.07.2008, “Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Arjana Fullani anëtare e Gjykatës së Lartë”.

14.2 Trupa Gjyqësore e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 04, datë 29.06.2017, ka vendosur deklarinimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, për znj. Arjana Fullani. Vendimi në fjalë referohet në faktin se gjyqtarja Arjana Fullani ka përfunduar mandatin 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës si gjyqtare e Gjykatës së Lartë, në bazë të pikës 2 të nenit 139 të Kushtetutës.

14.3 Më datë 31.07.2017, znj. Arjana Fullani i drejton kryetarit të Gjykatës së Lartë njoftimin “Për dorëzimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë”.

14.4 Kryetari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.07.2017, ka informuar Presidentin e Republikës, në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, se në bazë të pikës 2 të nenit 139 të Kushtetutës, trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë vendosi të deklarojë të përfunduar mandatin e pesë anëtarëve të saj, përfshirë dhe mandatin e znj. Arjana Fullani.

² Vendimi nr. 206, datë 28.07.2008, i Kuvendit është bazuar në dekretin nr. 5791, datë 08.07.2008, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë “Për emërimin e anëtares së Gjykatës së Lartë” dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 31.07.2008.

14.5 Më datë 25.04.2018, subjekti i rivlerësimit njofton Presidentin e Republikës në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dorëzimin e detyrës të kryetari i Gjykatës së Lartë më datë 31.07.2017, dhe nga kjo datë nuk ushtron më detyrën e gjyqtare. Sipas pretendimeve të subjektit, znj. Arjana Fullani, nëpërmjet këtij komunikimi, në kushtet kur nuk kishte paraqitur kërkesë për t'u emëruar gjyqtare apeli, kishte filluar ushtrimin e veprimtarisë private në profesionin e avokates dhe i kishte përfunduar statusi i gjyqtare për shkak të ligjit, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016 që përcaktojnë subjektet e rivlerësimit, ajo nuk ishte më subjekt i këtij ligji.

14.6 Më datë 30.04.2018, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision njoftimin, sipas të cilit, bazuar në të drejtën që i njej ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përkatësisht neni 62 i tij, nuk ka paraqitur kërkesë për t'u emëruar gjyqtare në gjykatën e apelit dhe se ka filluar ushtrimin e veprimtarisë private në profesionin e avokatit duke u regjistruar si person fizik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, më datë 29.01.2018, pajisur me NIPT L8329036O. Subjekti i rivlerësimit vlerëson se statusi si gjyqtare ka mbaruar për shkak të ligjit (mbarim mandati) dhe në kushtet e përfundimit të këtij statusi, si dhe në zbatim të neneve 3, pika 16 dhe 58 të ligjit nr. 84/2016, nuk është më subjekt i këtij ligji.

14.7 Komisioni, në shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2018, drejtuar subjektit, ndër të tjera, vlerëson se, megjithëse subjektit të rivlerësimit i ka mbaruar mandati si anëtare e Gjykatës së Lartë, për shkak të ligjit vijon të gëzojë statusin e magjistrates. Neni 62, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 është kujdesur që t'i garantojë subjektit vazhdimësinë e punës në sistemin e drejtësisë, me përfundimin e mandatit si anëtare e Gjykatës së Lartë dhe se gëzon të drejtën që, me kërkesën e saj, të jetë ende pjesë e sistemit të drejtësisë si gjyqtare në gjykatën e apelit. Për sa më sipër, Komisioni ka informuar zonjën Arjana Fullani se ndërprerja e procedurave të rivlerësimit mund të bëhet vetëm nëse vërtetohen kushtet e parashikuara nga neni G i Aneksit të Kushtetutës.

14.8 Në vijim të shkresës së sipërcituar të Komisionit, subjekti i rivlerësimit më datë 03.12.2018, i është drejtuar përsëri Komisionit duke parashtruar ndër të tjera se nuk ka më objekt për procedimin administrativ të tij e, për këtë arsye, sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i vetmi vendim që mund të marrë Komisioni është pushimi/ndërprerja e procesit të rivlerësimit.

14.9 Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.01.2019, i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim "KLGj") duke i vënë në dispozicion të gjithë praktikën, të përbërë nga komunikimet shkresore të mbajtura me subjektin e rivlerësimit dhe dokumente të tjera të administruara që kanë të bëjnë me mbarimin e mandatit të gjyqtare së Gjykatës së Lartë, duke kërkuar vlerësimin dhe qëndrimin e këtij institucioni lidhur me procedurat për statusin e magjistratit të subjektit të rivlerësimit.

14.10 Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke marrë shkas nga shkresa e Komisionit, i drejtohet subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 03.04.2019, duke i kërkuar konfirmim për realizimin e së drejtës së saj ligjore për t'u caktuar në një pozicion nivel apeli, duke e informuar për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Vlorë dhe duke i kërkuar shprehjen e interesit për realizimin nga ana e KLGj-së të kësaj të drejte ligjore. Po në këtë shkresë, thuhet se KLGj-ja do të konsiderojë ndjekjen e procedurave ligjore të parashikuara nga ligji nr. 96/2016, në të kundërt ky institucion do të duhet të konsiderojë mbajtjen ose jo të statusit të magjistratit për subjektin.

14.11 Me përgjigjen e datës 08.04.2019, drejtuar KLGj-së, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se *nuk dëshiron të emërohet si gjyqtare në nivel apeli as tani e as në të ardhmen.*

14.12 Në vijim, KLGj-ja, me vendimin nr. 67, datë 24.04.2019, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli. Ky vendim i përcillet Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 25.04.2019, dhe i njoftohet subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 30.04.2019.

14.13 Në rrethanat e mësipërme Komisioni, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, me vendimin nr. 186, datë 23.07.2019, vendosi të ndërpresë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, dhe deklarimin e humbjes së të drejtës së saj për t'u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.

15. Trupi gjykues i Kolegjit, duke iu referuar fakteve më sipër, vlerëson të rëndësishëm për këtë çështje evidentimin e faktit të shprehjes së vullnetit të subjektit të rivlerësimit për heqje dorë nga ushtrimi i detyrës së gjyqtares, të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, i cili gjatë procesit të rivlerësimit përbën shkak ligjor për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, me kufizimin për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
16. Sa i përket pretendimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në seancë gjyqësore publike, *nëse mund të vazhdonë ushtrimin e detyrës në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Lartë edhe pas përfundimit të mandatit sipas parashikimeve të ligjit nr. 76/2016*, të trajtuar dhe në vendimin e Komisionit, trupi gjykues së pari vlerëson se argumentet e dhëna nga Komisioni në vendim nuk janë relevante dhe se mbajtja e një qëndrimi për këtë pretendim nuk ka efekt në vendimin e themelit pasi, pavarësisht nëse do të konsideronim që subjekti kishte apo jo detyrimin për të qëndruar në detyrë edhe pas mbarimit të mandatit si anëtare e Gjykatës së Lartë, ky konkluzion nuk do të afektonte zbatimin e nenit 64, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 96/2016, e cila në rastin objekt shqyrtimi është e vetmja dispozitë ligjore që i jep fund statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit dhe qëndrimet e mbajtura nga Komisioni që lidhen me këtë pikë konsiderohen jorelevante në zgjidhjen e çështjes objekt i këtij gjykimi, për sa kohë nuk ndikojnë në interpretimin e vullnetit të subjektit për të mos u emëruar si gjyqtare apeli si dorëheqje nga detyra, në kuptim të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 e, për rrjedhojë, aplikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
17. Trupi gjykues, në lidhje me pretendimin tjetër të ngritur nga subjekti i rivlerësimit, se *kur fillon dhe mbaron statusi i magjistratit për anëtares e Gjykatës së Lartë dhe nëse statusi përfundonte për efekt të ligjit me mbarimin e mandatit kushtetues 9-vjeçar*, në kuptim të nenit 161, pika 1 e ligjit nr. 96/2019 që parashikon se: *Gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet magjistrat sipas këtij ligji*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, si gjyqtare në detyrë e Gjykatës së Lartë, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, gëzonte statusin e magjistratit sipas këtij ligji. Ndërsa sa i përket mbarimit të statusit të magjistratit të subjektit, neni

64, pika 1³ e po këtij ligji parashikon në mënyrë shteruese rastet e mbarimit të statusit të magjistratit dhe nuk lë mundësinë që ligje të tjera të parashikojnë situata shtesë të cilat shkaktojnë këtë pasojë. Duke nënvizuar faktin që kjo dispozitë ligjore është miratuar pas ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, ligjvënësi e kishte krejtësisht të qartë panoramën që krijohej me mbarimin e mandateve të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, që do të thotë se nuk kemi të bëjmë me një ometim të ligjit, por me një parashikim të qartë se statusi vazhdon të ruhet pas përfundimit të mandatit. Për rrjedhojë, mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk çon në mbarimin e statusit të magjistratit, pasi vetë neni 62, pika 1 e po këtij ligji ka parashikuar të drejtën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë që në fund të mandatit t'i njihet e drejta për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli. Pra, vetë ligji për statusin e magjistratit u garanton kështu anëtarëve të Gjykatës së Lartë që u mbaron mandati, vazhdimësinë e punës në sistemin e drejtësisë dhe, për pasojë, gëzimin e statusit të magjistratit në vazhdim.

18. *Subjekti i rivlerësimit në ankim i referohet paragrafit 7.1 të Kartës Evropiane mbi Statusin për Gjyqtarët, ku konstatohet se një gjyqtar pushon përfundimisht së ushtruar funksionet nëpërmjet: [...] përfundimit të afatit të caktuar ligjor [...]. Subjekti pretendon se në nenin 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, për mbarimin e statusit të magjistratit janë parashikuar të gjitha pikat, përveç pikës 4 të parashikuar në Kartën Evropiane, që bën fjalë për “përfundimin e funksionit/statusit për shkak të përfundimit të funksionit sipas një afati të caktuar ligjor”. Duke qenë se Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës dhe ka detyrimin të zbatojë aktet që dalin prej tij, ky akt merr një karakter detyrues dhe duhet të zbatohet në praktikën e brendshme, krahas ligjeve tona të brendshme, madje të prevalojë në zbatimin e tyre.*

Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se dispozitat e Kartës Evropiane mbi Statusin për Gjyqtarët, të krijuara kryesisht nga praktikat më të mira të vendeve, paraqiten si mjet optimal me natyrë orientuese për interpretimin dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit për çështjet disiplinore, me qëllim garantimin e gjyqtarit kundër humbjes arbitrare të statusit të tij, në kuadër të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit. Karta është një garanci kundër largimit të detyruar nga gjyqësori për shkak të humbjes së statusit, dhe jo garanci për të kundërtën, pra mbarimit të statusit për shkak të largimit nga gjyqësori me vullnetin e gjyqtarit. Procedura e ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, nëpërmjet shprehjes së vullnetit të saj të pavesuar për heqje dorë nga detyra e gjyqtare, është plotësisht në përputhje me garancitë që parashikon Karta. Trupi gjykues vlerëson se në procesin e rivlerësimit, për shkak të specifikave dhe qëllimit të tij, kuadri ligjor normues është i plotë dhe i mirëpërcaktuar, i hartuar nën ekspertizën evropiane dhe i bazuar në parimet dhe standardet e pranuar ndërkombëtare.

19. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e paraqitura në seancë gjyqësore publike, nëse mund të penalizohet nga mosaplikimi i një të drejte të dhënë nga ligji, trupi gjykues nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstaton:

19.1 Referuar komunikimeve zyrtare të subjektit të rivlerësimit me Komisionin, ka rezultuar se subjekti ka kërkuar ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit, me pretendimin se i) *statusi i saj si gjyqtare kishte mbaruar pasi kishte përfunduar mandati si anëtare e Gjykatës së Lartë*; ii) *nuk kishte paraqitur kërkesë për t'u emëruar gjyqtare apeli*; dhe iii) *kishte filluar të ushtronte*

³ Neni 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 parashikon: 1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohet kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën e pensionit; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën [...]

veprimtarinë private në profesionin e avokates dhe, për rrjedhojë, nuk ishte më subjekt rivlerësimi në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, objekti për të cilin kishte nisur procedura, ishte bërë i pamundur sipas përcaktimit të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këto kushte, Komisioni i është drejtuar KLGj-së duke kërkuar vlerësimin e qëndrimin e këtij institucioni lidhur me procedurat mbi statusin e magjistratit të subjektit.

19.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor, nisur nga kërkesa e Komisionit, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.04.2019, i drejtohet subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, duke i bërë me dije se, *bazuar në nenin 139, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 61, pikat 4 dhe 62 të ligjit nr. 96/2016 [...], në cilësinë e ish-gjyqtarës së Gjykatës së Lartë, mandat ky që është deklaruar i mbaruar me vendimin nr. 4, datë 29.06.2017, të Gjykatës së Lartë, ju gëzoni të drejtën për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli.* Në vijim të kësaj shkrese, KLGj-ja informon subjektin se ekzistonin disa pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Vlorë dhe, nisur nga fakti që nuk është depozituar asnjë kërkesë në lidhje me realizimin e së drejtës për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, e fton subjektin të konfirmojë interesin për realizimin nga ana e KLGj-së së kësaj të drejte ligjore.

19.3 Me përgjigjen e datës 08.04.2019, subjekti i rivlerësimit i ka konfirmuar KLGj-së faktin se ***nuk dëshiron të emërohet si gjyqtare në nivel apeli as tani e as në të ardhmen.*** KLGj-ja, në përfundim të procedurës, me vendimin nr. 67, datë 24.04.2019, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani, *për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel apeli.*

20. Në analizë të akteve të sipërcituara dhe të parashtrimeve në seancë gjyqësore, trupi gjykues çmon se mospranimi i subjektit të rivlerësimit, pas përfundimit të mandatis si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 62, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, për t'u caktuar në një pozicion në nivelin e gjykatës të apelit, *as tani as në të ardhmen*, është shprehje e vullnetit të saj për heqjen dorë nga ushtrimi i detyrës si gjyqtare në nivel apeli, si e drejtë e garantuar për shkak të gëzimit të statusit të magjistratit. Në këtë rast, me të drejtë Komisioni ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, duke zbatuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës, duke deklaruar humbjen e së drejtës së subjektit për t'u emëruar në funksionet e parashikuara nga kjo dispozitë për një periudhë 15-vjeçare.
21. Trupi gjykues vlerëson se refuzimi i vazhdimit të “kontratës” me shtetin për të qenë gjyqtare në nivel apeli, kontratë e lidhur me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, sjell si pasojë humbjen e statusit të magjistratit, ndërsa në kuadër të procesit të rivlerësimit ky refuzim parashikohet si heqje dorë nga detyra e gjyqtarës. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Kur subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e vet nuk pranoi të caktohej si gjyqtar në nivel apeli, detyrë që e bënte subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të kishte marrë parasysh dhe pasojat ligjore të parashikuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.
22. Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe të parashtruara gjatë seancës gjyqësore publike, ka vlerësuar si më poshtë vijon.
23. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se Komisioni ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes, pasi pikat 12 dhe 34 të vendimit u referohen komunikimeve shkresore të subjektit me Komisionin para se të hidhej shorti dhe të caktohej trupi gjykues.* Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues

gjen të pabazuar komunikimin shkresor të titullarit të Komisionit me subjektin e rivlerësimit, lidhur me kërkesën e këtij të fundit për ndërprerje të procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se vërtet titullari i Komisionit përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët, por në asnjë rast nuk duhet të kërkojë, të administrojë prova dhe të hetojë për çështje të veçanta, gjë e cila është kompetencë vetëm e trupit gjykues të shortuar për kryerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin. Ky fakt përbën një shkelje nga ana Komisionit e, për rrjedhojë, Kolegji i dha mundësi subjektit të rivlerësimit të dëgjohej e të shprehë vullnetin e vet të plotë përpara Kolegjit në seancë gjyqësore publike, duke korigjuar kështu të metat e procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

24. *Sa i përket pretendimit të subjektit se nguti i vazhdueshëm për të kaluar me shpejtësi në sitën e vettingut të pesë ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë pa asnjë detyrë e funksion në sistemin gjyqësor, e bën këtë proces të paragjykuar, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit inicioi me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si një detyrim ligjor i parashikuar në nenin 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës: 4. Çështjet për rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm do të trajtohen me përparësi në kohë nga institucionet e rivlerësimit. Për më tepër kur veprimtaria procedurale e Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, inicioi konkretisht me shkresat e saj të datave 30.04.2018 dhe 03.12.2018 drejtuar Komisionit, për ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit, në një kohë kur ende nuk ishte caktuar trupi gjykues i shortuar i Komisionit që do të kryente procesin e rivlerësimit, bën që pretendimi i subjektit të jetë i pambështetur.*
25. *Lidhur me pretendimin e subjektit se nëpërmjet nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ligjvënësi parashikon dhe mundësinë e ish-gjyqtarëve, ish-prokurorëve, ish-këshilltarëve të Gjykatës së Lartë të cilët kanë punuar në këtë pozicion të paktën tre vjet, t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, duke e lënë në dëshirë të tyre, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk është në kategorinë e subjekteve të parashikuara në këtë dispozitë, që u adresohet ish-gjyqtarëve e ish-prokurorëve të cilët nuk ishin në detyrë në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe nuk i nënshtrohen procesit të rivlerësimit ex officio, duke iu dhënë mundësinë që me kërkesën e tyre t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit, në përfundim të të cilit do të vendosej sipas parashikimit të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
26. *Lidhur me pretendimin e subjektit se penaliteti në pikën 2 të vendimit të Komisionit e stigmatizon në jetën profesionale, pasi jo vetëm që e përjashton nga organet e drejtësisë, por dhe në karrierën private, pasi vetë fakti që është përjashtuar nga organet e vetting-ut, krijon probleme me mësimdhënien, me pjesëmarrjen në projekte të caktuara, pjesëmarrje në borde të ndryshme etj., pra ndikon drejtpërsëdrejti në jetën profesionale, trupi gjykues çmon se shkon përtej objektit të veprimtarisë së institucioneve të rivlerësimit dhe vlerëson se ky interes i pretenduar i subjektit, nën frymën e parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, nuk e legjitimon atë që këtë pretendim t'ia drejtojë Kolegjit.*
27. *Për sa i përket pretendimit që subjekti ngre mbi standardet e dyfishta të përdorura nga Komisioni në situata të njëjta juridike, siç është rasti i shqyrtimit të çështjes së subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., trupi gjykues çmon se rasti objekt gjykimi nuk ndodhet në të njëjtat kushte me çështjen e trajtuar në vendimin nr. 115, datë 11.03.2019, të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., pasi në rastin e fundit, subjekti iu nënshtrohet hetimit të plotë administrativ dhe në asnjë rast subjekti nuk paraqiti në Komision kërkesë për ndërprerjen apo pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., Komisioni arriti në përfundimin se subjekti nuk gëzonte statusin e magjistratit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, duke e*

klasifikuar në kategorinë e inspektorëve jomagjistratë, për të cilët aplikohen pikat 2 dhe 4 të nenit 42 të këtij ligji mbi vlerësimin profesional. Për këtë arsye, Komisioni përfundoi procesin e rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura apo qëllimi i tij bëhet i pamundur. Ndërkohë që për rastin objekt shqyrtimi, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ushtronte efektivisht detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe ishte subjekt i procesit të rivlerësimit *ex officio*. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.

28. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni mban standard të dyfishtë pasi trajton ndryshe gjyqtarët të cilët kishin dorëzuar deklaratën vetting gjatë kohës që ishin në detyrë, por kur filloi punën Komisioni, dolën në pension, njësoj si subjekti në rastin e mbarimit të mandatit, por për ta Komisioni deklaroi të përfunduar procesin pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është i pamundur. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se mes rastit objekt gjykimi dhe atij të trajtuar në vendimin nr. 126, datë 27.03.2019, të Komisionit, të cilit i referohet subjekti në ankim, ka ndryshime, pasi dalja në pension pleqërie⁴ është parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 96/2016, si një nga rastet kur mbaron statusi i magjistratit, i klasifikuar në nenin 64, pika 1, germa “b”. Në rast se verifikohen këto rrethana, statusi mbaron për këtë shkak dhe jo për shkak të vullnetit të subjektit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.*
29. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i KLGj-së nr. 67, datë 24.04.2019, është i pabazuar në ligj pasi shkak ligjor i përdorur prej tij nuk është i parashikuar në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, duke bërë një interpretim të gabuar të ligjit dhe gjetur një shkak ligjor që nuk ekziston në ligj. Trupi gjykues vëren se vendimi nr. 67, datë 24.04.2019, i Këshillit të Lartë Gjyqësor deklaroi të mbaruar statusin e magjistratit për subjektin, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli. Refuzimi i emërimit në gjykatë apeli, në vlerësimin e trupit gjykues, barazohet me dorëheqjen nga detyra, duke qenë se asnjë rast tjetër i mbarimit të statusit, parashikuar në nenin 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, nuk është verifikuar se ekziston. Fakti që subjekti i rivlerësimit pretendon se ky refuzim nuk është dorëheqje, është i pabazuar. Për sa arsyetuar më sipër, duke qenë se mbarimi i mandatit 9-vjeçar si anëtare e Gjykatës së Lartë nuk përbën shkak ligjor për mbarimin e statusit të magjistratit, asnjë rast tjetër i parashikuar në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 nuk kualifikon vullnetin e subjektit që refuzon emërimin, përveç institutit të dorëheqjes.*
30. *Mbështetur në arsyetimin më sipër, trupi gjykues vlerëson se ndodhemi në kushtet e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarës, për të cilën Kushtetuta parashikon vetëm ndalimin në nenin G, pika 2 e Aneksit të saj *ita lex scripta est*.*
31. *Trupi gjykues, pasi dëgjoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësueses ligjore të saj, në seancën gjyqësore publike të datës 04.11.2020, si dhe pasi analizoi në mënyrë të hollësishme provat e administruara në dosjen gjyqësore, gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e Komisionit në pikën 2 të dispozitivit të tij, që parashikon humbjen e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i*

⁴ Para ndryshimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me ligjin nr. 48/2019.

Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

32. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit për zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 186, datë 23.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 11.11.2020.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Albana Shtylla dhe Sokol Çomo, nuk jemi dakord me vendimin nr. 30, datë 11.11.2020, të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) për shqyrtimin e vendimit nr. 186, datë 23.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani. Nëpërmjet këtij vendimi, shumica e trupit gjykues vendosi të lërë në fuqi vendimin e sipërcituar të Komisionit. Ne gjyqtarët në pakicë kemi votuar për prishjen e vendimit të Komisionit për arsye të mëposhtme.
2. Komisioni, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, me vendimin nr. 186, datë 23.07.2019, ka vendosur:
 1. *Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, është ndërprerë.*
 2. *Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. [...]*
3. Ky vendim i Komisionit është bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) nr. 67, datë 24.04.2019, me të cilin ky i fundit ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykatë apeli.
4. Me ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar pikën 2 të vendimit të Komisionit duke pretenduar se ajo nuk bazohet në fakte dhe në ligj.
5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, pasi është njoftuar nga Kolegji për shqyrtimin e ankimit të saj në dhomë këshillimi, i ka paraqitur trupit gjykues një kërkesë për pezullimin e gjykimit të çështjes, duke qenë se, nëpërmjet një padie të ngritur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kishte kundërshtuar pjesërisht vendimin e KLGj-së nr. 67, datë 24.04.2019, me objekt *shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ nr. 67, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë Arjana Fullani, për shkak të mbarimit të mandatit.*
6. Në fillim të gjykimit të çështjes mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, trupi gjykues mori në shqyrtim këtë kërkesë. Ne gjyqtarët në pakicë kemi votuar për pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, për pezullimin e gjykimit në Kolegj deri në zgjidhjen e çështjes gjyqësore administrative. Shumica e trupit gjykues mori vendim për rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e gjykimit.
7. Gjatë gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni e kishte marrë vendimin nr. 186, datë 23.07.2019, duke mos e ftuar subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, në seancë dëgjimore. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se subjektit të rivlerësimit i ishte cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si pasojë e mohimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur. Për pasojë, trupi gjykues, me qëllim korrigjimin e këtij gabimi procedural të Komisionit, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit. Pasi trupi gjykues dëgjoji në seancë gjyqësore publike subjektin e rivlerësimit, znj.

Arjana Fullani, dhe avokaten e saj, ne gjyqtarët në pakicë kemi kërkuar pezullimin e gjykimit të çështjes derisa të zgjidhet çështja gjyqësore administrative që lidhet me kontrollin e aktit administrativ individual të KLGj-së mbi statusin e magjistratit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani. Shumica e trupit gjykues vendosi të vazhdojë gjykimin e çështjes dhe marrjen e vendimit për zgjidhjen e saj.

8. Në vlerësimin tonë, Kolegji, në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe në nenin F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, ka kompetencë të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit ndaj vendimeve të Komisionit, por jo ankimet ose pretendimet e magjistratëve kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë lidhur me mbarimin e statusit të tyre, edhe kur ato sjellin efekte të drejtpërdrejta në procesin e rivlerësimit kalimtar.
9. Për ne gjyqtarët në pakicë, Kolegji nuk ka juridiksion të vlerësojë në rastin konkret çështjen lidhur me mbarimin e statusit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, në kushtet kur, referuar nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është KLGj-ja organi kompetent për vendimmarrjen lidhur me të. Për sa i takon kontrollin të aktit administrativ individual të Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, referuar nenit 100⁵, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, këtë kompetencë e ka Gjykata Administrative e Apelit. Në këto kushte, me të drejtë subjekti i rivlerësimit, padinë për kundërshtimin e vendimit të KLGj-së nr. 67, datë 24.04.2019, e ka ngritur para Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe nuk e ka bërë pjesë të objektit të ankimit të saj në Kolegji. Nëpërmjet kërkesës për pezullimin e gjykimit të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka bërë të qartë se vetëm pasi të përfundonte çështja gjyqësore administrative lidhur me shkakun e përfundimit të statusit të magjistratit për të, Kolegji mund të vendoste për zgjidhjen e drejtë të çështjes, duke qenë se vetëm atëherë ai do të kishte një konfirmim përfundimtar, pas kontrollit gjyqësor, nëse subjekti e kishte humbur apo jo statusin e magjistratit si pasojë e dorëheqjes.
10. Në gjykimin tonë, vendimi i Komisionit është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e vendimit të KLGj-së nr. 67, datë 24.04.2019, i cili aktualisht ndodhet në proces kontrolli pranë gjykatës kompetente të caktuar me ligj. Kolegji e ka të pamundur të zgjidhë në mënyrë të drejtë çështjen, për sa kohë nuk është zgjidhur çështja gjyqësore administrative lidhur me kontrollin gjyqësor të vendimit të sipërcituar të KLGj-së. Kolegji nuk mund të përthithë kompetencën që ligjvënësi shprehimisht ia ka dhënë Gjykatës Administrative të Apelit, me interpretimin se në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, ai mund të bëjë edhe zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje gjyqësore administrative që ka lidhje të drejtpërdrejtë me këtë proces. Në gjykimin tonë, i takon vetë Gjykatës Administrative të Apelit të vlerësojë nëse padia e cila i është paraqitur për gjykim nga subjekti i rivlerësimit, është apo jo në juridiksionin dhe kompetencën e saj, vendimmarrja e së cilës mund të kontrollohet në rast kundërshtimi nga palët vetëm nga Gjykata e Lartë.

⁵ Neni 100, pika 1 e ligjit nr. 115/2016, në kohën e marrjes së vendimit të KLGj-së nr. 67, datë 24.04.2019, parashikonte:

“1. Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese”.

11. Pakica vlerëson se në rastin e një vendimmarrjeje të mundshme të Gjykatës Administrative të Apelit, bazuar në nenin 107 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative, për konstatimin e paligjshmërisë apo pavlefshmërisë absolute⁶ të vendimit të KLGj-së nr. 67, datë 24.04.2019, pas dhënies nga Kolegji të vendimit për ankimin e subjektit të rivlerësimit, kjo vendimmarrje do të sillte pasoja të drejtpërdrejta mbi efektet ligjore të vendimit të Kolegjit. Për pakicën, një situatë e tillë procedurale duhet të shmanget pasi mund të cenojë bazueshmërinë dhe drejtësinë e vendimit të Komisionit e, për rrjedhojë, edhe vendimin e Kolegjit për këtë çështje.
12. Ky arsyetim i pakicës bazohet edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës, në trajtimin e çështjeve të ngjashme prej tij, si një nga parakushtet procedurale për marrjen e vendimeve në rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit në kuadër të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka vlerësuar të domosdoshme që vendimet e KLGj-së lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit të kenë marrë formë të prerë⁷.
13. Për situatën faktike procedurale, si dhe për analizën ligjore të parashtruar si më lart, ne gjyqtarët në pakicë vlerësuam se shqyrtimi gjyqësor i çështjes në Kolegji, bazuar në parashikimet e nenit 297, paragrafi i parë, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, duhej të pezullohej deri në zgjidhjen e çështjes gjyqësore administrative. Në kushtet kur shumica vendosi t’i japë fund shqyrtimit gjyqësor dhe të tërhiqej për marrjen e vendimit përfundimtar, e vetmja zgjidhje e drejtë në vlerësimin tonë ishte prishja e vendimit të Komisionit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, alternativë për të cilën edhe votuam.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

⁶Neni 110 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon:

“1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit.

3. Në rast se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme dhe kjo pjesë është aq e rëndësishme saqë organi publik nuk do ta kishte nxjerrë aktin pa të, i gjithë akti është i absolutisht i pavlefshëm”.

⁷Në vendimin e Kolegjit (JR) 19/2020, në paragrafin 24 e vijim, Kolegji ka arsyetuar:

“24. Në analizë të fakteve të parashtruara më sipër, trupi gjykuës, pasi konstatoi se:

[...] 24.4. Referuar sa më sipër, si dhe pikës 4 të vendimit të KLGj-së nr. {***}, datë 07.07.2020, në të cilin parashikohet se ndaj vendimit në fjalë mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, vendimi i sipërcituar i KLGj-së, në datën 28.07.2020, ora 16:00, komunikuar në korrespondencën zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka qenë i formës së prerë.

– arrin në përfundimin se, me dhënien e dorëheqjes nga detyra e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përpara KLGj-së dhe pasi vendimi i kësaj të fundit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit ka marrë formë të prerë, subjekti i rivlerësimit, znj. R. P., ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni G i Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, bëhet subjekt i zbatimit të kësaj dispozite kushtetuese.